



Titulli i projektit

Rehabilitim i qendrës së komunës Bytyç, Tropojë

Tipi i projektit

Zhvillim ekonomik/ Shërbime Publike/ Projekte që mobilizohen shpejt

Vendndodhja e projektit

Komuna Bytyç

Buxheti i paravlerësuar

70,000 Euro

Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Komuna Bytyç ka një popullsi prej rreth 2200 banorë, sipas Zyrës së Gjendjes Civile. Qendra e kësaj komune, ndodhet në fshatin Pac, i cili ka një popullsi prej 400 banorë. Pranë kësaj qendre ndodhen disa institucione shtetërore, private dhe religjioze, duke përfshirë administratën e njësisë vendore, qendrën shëndetësore, shkollën 9-vjeçare, xhaminë e fshatit dhe biznese të vogla private. Si e tillë, qendra e komunës Bytyç është e frekuentuar nga banorët e fshatit dhe fshatrave të tjerë që kërkojnë kryesisht shërbime publike, si dhe nxënësit e shkollës 9-vjeçare. Qendra e komunës ofron një mjedis të papërshtatshëm për banorët e fshatit Pac dhe fshatrave të tjerë. Në një sipërfaqe prej 1500 m<sup>2</sup>, e konsideruar si qendër komune, mungojnë mjediset e gjelbërta, trotuarët për kalimtarët, si dhe ndriçimi i sheshit. Njëkohësisht, po në këtë shesh kalon edhe kanali i ujrave që përdoren për vadijen e tokave, i cili është i amortizuar. Prej kohësh nuk është investuar në këtë drejtim. Ky mjedis është i papërshtatshëm për lëvizjen e komunitetit, që bëhet më e vështirë në kohën dimrit. Fëmijët që frekuentojnë shkollën kalojnë në rrugët me balltë dhe shpesh me rrezik, për shkak të mungesës së trotuareve dhe ndriçimit. Nevoja për përmirësimin në këtë qendër është e dukshme. Projekti është në përputhje me studimin e zonës funksionale Tropojë përsa i përket përmirësimit të kohezionit social të komunitetit.

Qëllimi/et specifik të projektit

1. Përmirësimi i lëvizjes për banorët e fshatit Pac, qendra e komunës Bytyç, nëpërmjet rregullimit të territorit, trotuareve dhe ndriçimit.
2. Rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit për mirëmbajtjen e investimit.

Rezultatet e pritshme dhe treguesit

Projekti i propozuar do të ndikojë në:

1. Trotuare për kalimtarët, banorë të fshatit Pac dhe fshatrave të tjerë.
2. Ndriçim të përshtatshëm përgjatë trotuareve të qendrës së komunës.
3. Kanal vaditës i rikonstruktuar;
4. Mjedis të përshtatshëm dhe të kulturuar për banorët e fshatit Pac dhe banorëve të fshatrave të tjera, që marrin shërbime publike pranë komunës Bytyç.
5. Banorë të kënaqur për mjediset e krijuara.

Numri i popullsisë përfituese: 400 banorë të komunës Bytyç (25% e popullsisë së komunës Bytyç; rreth 1800 banorë të fshatrave të tjera, brenda territorit të komunës Bytyç).

# PROJEKTI 9



program i zonave funksionale

# pzf

## Aktivitetet e projektit

Aktivitetet e projektit për realizimin e objektivave të mësipërme përfshijnë:

1. Sistemimi i sheshit të qendër komunës;
2. Ndërtimi i trotuareve;
3. Vendosija e ndriçimit;
4. Ndërgjegjësimi i komunitetit.

Projekti do të realizohet për një periudhë 4-mujore.

## Maturimi i projektit

Projekti i propozuar është në fazën e një projekt-ideje. Nuk ka projekte pranë komunës për sistemimin dhe rregullimin e qendrës së komunës për mungesë të fondeve. Është një nevojë jetike dhe me prioritet për këtë komunë.

## Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Rregullimi dhe sistemimi i ambienteve publike është funksion i drejtpërdrejtë i njësisë së qeverisjes vendore. Si i tillë, ai do të zbatohet nga kjo njësi.

Financimi i projektit do të bëhet nga: Bashkia Tropojë, komuniteti, donatorët vendas dhe të huaj.

## Kostot e projektit

Kostoja totale e projektit është 70,000 Euro.